
TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: Ekspert/e për edukimin mbi sipermarrjen

Numri i kërkuar: 1(Një)

Tipi i Kontratë: Kontratë Shërbimi

Kontraktuesi: Organizata Përtej Barrierave

Kohëzgjatja: 18 Mars 2019- 18 Maj 2019

Afati i fundit i aplikimit: 15 Mars 2019

RRETH ORGANIZATËS

Përtej Barrierave është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse e cila është themeluar në Qershor të vitit 2004 nga një grup te rinjsh me aftësi të kufizuar dhe të rinj të tjerë që sot janë pjesë e bordit drejtues të organizatës.

Misioni i organizatës është: të promovojë mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë dhe vecanerisht për të rinj me disavantazhe sociale duke u ofruar atyre mbështetje për tu fuqizuar dhe marrë pjese aktive në jetën e komunitetit. Qëllimi ynë kryesor është të integrojmë të rinjtë me probleme sociale dhe disavantazhe në shoqëri.

RRETH PROJEKTIT

Organizata Përtej Barrierave është hostuese e projektit “Mentaliteti i sipërmarjes nëpërmjet inovacionit social në punën me të rinjtë” I cili financohet nga Komisioni European Me pjesëmarrjen e 8 organizatave të tjera partnere nga Ballkan dhe Europa. Organizata Thy- Kosovë, Udruzenje Mladi Za Mir-Bosnia dhe Herzegovina, Beyond Barriers- Shqiperi, Mladezhko Evropeisko Obshtestvo- Bullgari, SFERA- Maqedonia Veriore, Asociatia Tinerilor Cu Initiativa Civica-Rumani, Somborski Edukativni Centar- Serbi, Gaziantep Egitim ve Genclik Dernegi- Turqi



Projekti synon të rrisë kapacitetet e konsorciumit në sipërmarrjen rinore dhe temen e inovacionit, dhe të adresojnë çështjet kyçe me interes për të rinjtë në ditët e sotme. Të përshpetojë përfshirjen e të rinjve me më pak mundësi përmes sigurimit të kompetencave në inovacionin social dhe sipërmarrjen.

Objektivat specifike janë:

- Të trajnojë Punonjësit rinorë në zhvillimin e aftësive dhe të menduarit kritik
- Të trajnojë punonjësit e rinisë në edukimin e sipërmarrjes dhe të eksplorojnë konceptet e lidhura siç janë të rinjtë sipërmarrjen, ndërmarrjen sociale për të vepruar si shumëfishues në të ardhmen;
- Për të përmirësuar aftësitë e punonjësve të rinisë në fushat e inovacionin social
- Të rritet përfshirja e të rinjve të marxhinalizuar në mënyrë active duke përfshirë dhe duke i lejuar ata të aplikojnë njohuritë e fituara në kontekstin lokal;
- Për të promovuar programin Erasmus + YiA dhe NFL

OBJEKTIVAT E TOR

Lidhur me këtë project Përtej Barrierave kërkon një ekspert/e për sipërmarrjen rinore. Qëllimi kryesor është trajnimi I të rinjve me anë të metodologjisë së edukimit jo-formal, mbi edukimin për sipërmarrjen rinore, hapat që duhet të meren për të krijuar një biznes. Ndarja e koncepteve të tilla si: Biznesi dhe Start-up. Aftësitë e sipermarresve, strategjitë që duhet të ndiqen për krijimin e nje modeli bizensi

Ai/Ajo do të jetë përgjegjës për dhënien e ekspertizës në këto fusha, si dhe për implementimin e sukseshëm të ideve të sipërmarrjes.

PROFILI I EKSPERTIT TË KËRKUAR

- Të jetë mbi 25 vjec
- Të ketë punuar më përpara me projekte rinore në fushën e edukimit jo-formal
- Të ketë diploma të shkollës së lartë.
- Njohja e aplikacioneve kompjuterike



-
- Njohje të gjuhës angleze dhe aftësi për të punuar në një ekip dhe në mënyrë të pavarur.
 - Të ketë njohuri të mira në fushën e sipërmarrjes rinore

PËRGJEGJËSITË

- Të ketë bashkëpunim të ngushtë me koordinatorin dhe stafin e organizatës Përtej Barrierave dhe të jetë i/e hapur ndaj sugjerimeve
- Të ketë aftësi për të punuar në grup

MARRËVESHJA ME KONTRAKTUESIN:

1. Eksperti/a i/e përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë me organizatën kontraktuese Përtej Barrierave.

2. Pagesa e ekspertit do të kryhet sipas rregullave të aplikuara me kontratë shërbimi. Pagesa do të kryhet siç është parashikuar në kontratën e shërbimit të firmosur nga Kontraktuesi dhe i Kontraktuari.

PERIUDHA E KONTRAKTIMIT:

Periudha e kontraktimit është 3 muaj nga data 18 Mars 2019- 18 Maj 2019, duke përfshirë dhe raportimin.

Procedurat e aplikimit:

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Curriculum Vitae e rifreskuar me të dhënat e fundit



-
- Letër interesi
 - Eksperienca të mëperparshme pune në këtë profil.

Proçesi i përzgjedhjes:

Propozimet e marra do të vlerësohen sipas kriteve të mëposhtme:

- Propozimi për teknik (eksperienca, CV-ja) (70%)
- Çmimi (30%)

KU TË APLIKONI:

Dërgoni aplikimin tuaj me të gjithë dokumentat e kërkuara në një e-mail të vetëm në adresën: office@beyondbarriers.org deri në datën 15 Mars 2019

